



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

N.20
Shtator
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Qendra Spitalore Universitare
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

UNIVERSITETI SI PIKËNISJE

Një rrugëtim rritjeje, dijeje dhe bashkëndarjeje

Duke ju uruar mirëseardhjen në **Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"** dua së pari t'ju përgëzoj ju dhe familjet tuaja për këtë moment të rëndësishëm që keni arritur.

Mirë se erdhët! Regjistrimi në universitet shënon një moment të rëndësishëm në jetën tuaj, një pikëmbërritje, por mbi të gjitha edhe një pikënisje jo vetëm për formimin tuaj profesional por edhe zhvillimin tuaj personal. Unë, së bashku me të gjithë stafin akademik dhe administrativ jemi në dispozicionin tuaj dhe jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi, jo vetëm për t'ju ofruar formimin e nevojshëm teknik e shkencor, por edhe atë njerëzor që sot më shumë se kurrë është kaq i domosdoshëm për t'u përballur me sfidat që na sjell bota moderne. Fundja, universitetet nuk janë thjesht vende të mësimnxënies, por edhe "institucione paqeje" ku kërkimi shkencor, shkëmbimi kulturor dhe dialogu kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më solidare, sipas mësimave të Papës Leon XIV.

Shpresoj që ta jetoni Universitetin për atë që gjithmonë duhet të jetë: një komunitet "universal" pedagogësh dhe studentësh ku kultura kultivohet mbi të gjitha si një interes i thellë dhe pasionant për botën dhe problemet e saj, për artin e profesionit dhe për kërkimin shkencor. Jini gjithmonë të gatshëm të mësoni, të dëgjoni dhe të vëzhgoni dhe mos ta bëni këtë gjë vetëm por së bashku.

Kjo mënyrë jetese nënkupton të jeni mendjehapur, kuriozë dhe të përvullur. Të punoni "së bashku" do t'ju mësojë rëndësinë e bashkëpunimit, dialogut dhe pasurimit të ndërsjellë. Ky është thesari i vërtetë i universitetit që do t'ju shoqërojë gjatë gjithë jetës.



Prof. Leonardo PALOMBI
Rektori i Universitetit Katolik
'Zoja e Këshillit të Mirë'
Tiranë

MIRËSEVINI!

Një vit i ri akademik po nis...

Një vit i ri akademik po nis dhe pas pak ditësh Kampusi Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" do të gumëzhijë sërish nga studentët dhe masantët e diplomuar që përzgjedhën UKZKM për rrugëtimin e tyre profesional. Kampusi ynë modern dhe shumë funksional do të jetë

për disa vite hapësira akademiko-sociale e qindra të rinjë që ditën e tyre gjatë sezonit akademik 2025-2026 do ta ndajnë mes studimeve, aktivitetet sportive apo atyre shoqërore.





Godinat universitare janë gati, labororet dhe sallat e leksioneve po kështu për t'ju përgjigjur interesit universitar të studentëve që vijnë nga shumë vende të botës, rajonit e sigurisht nga Shqipëria.

Për të rinjtë që vijnë për herë të parë në UKZKM do të jetë një përvojë e dobishme gjatë të cilës do të kenë mundësi të ndjekin dhe të bëhen pjesë e konferencave të shumta shkencore që janë planifikuar të mbahen. Punonjësit e Zyrës sonë të Pranimeve dhe ata të Sekretarive Mësimore janë gjithmonë mikpritës dhe në mbështetje të rishtarëve dhe jo vetëm që tashmë bëhen pjesë e historisë së Universitetit Katolik në Tiranë.

Programet tona të studimit janë reflektim i kurrikulave bashkëkohore me të njëjtat standarde si në vendet e Bashkimit Evropian. Çfarë na bën ne të dallueshëm është edhe numri i lartë dhe cilësor i profesorëve të huaj që ndjekin nga dita e parë deri në ditën e diplomimit studentët e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Ndaj ju urojmë një nisje të mbarë, një vit të suksesshëm akademik dhe shpresojmë që përkushtimi ynë në rritje akademike dhe njerëzore të shpërblehet me rritjen e brezave të rinj që i shërbejnë familjeve të tyre dhe shoqërisë.

BASHKËPUNIMI ME "BAMBINO GESÙ" PO KONKRETIZOHET

Model i ri
shëndetësor
në Shqipëri



Bambino Gesù
OSPEDALE PEDIATRICO

Gjatë muajit gusht **Kompleksi Spitalor dhe Universitar Zoja e Këshillit të Mirë** u vizitua sërish nga një delegacion i Spitalit Pediatrik Bambino Gesù i Romës, një strukturë e kualifikuar dhe e njohur në të gjithë botën për kujdesin dhe ndihmën ndaj fëmijëve të sëmurë dhe familjeve të tyre.

Delegacioni u mikprit nga Presidenti i Fondacionit "Zoja e Këshillit të Mirë" fr. Ruggero Valentini, Rektori i UKZKM Prof. Leonardo Palombi dhe Drejtori Mjekësor i Spitalit Katolik në Tiranë prof. Fabian Cenko.

Prej kohësh dy institucionet po punojnë së bashku për të krijuar një model të ri të shërbimeve shëndetësore në Tiranë, në bashkëpunim me autoritetet qeveritare shqiptare bazuar në praktikat dhe standardet më të mira të Spitalit Bambino Gesù. Spitali i Vatikanit u përfaqësua nga Drejtori i tij Mjekësor Dr. Massimiliano Raponi dhe Drejtori i Marrëdhënieve Ndërkombëtare Dr. Alessandro Cristaldi. Presidenti i Spitalit Bambino Gesù Prof. Tiziano Onesti mori pjesë online në sesionin e fundit të diskutimeve



Bashkëpunimi në fushat e kujdesit shëndetësor, klinik, shkencor dhe arsimor u diskutua gjerësisht duke u bazuar në përvojën e konsoliduar të Spitalit Bambino Gesù, i cili ka ofruar shërbime në të gjithë botën me afërsisht njëzet projekte ndërkombëtare që nga skajet më të largëta të Azisë deri në skajet më të largëta të Afrikës.

Kompleksi Universitar Spitalor Katolik i Tiranës përfaqëson shtratin ideal për krijimin e një modeli progresiv të bazuar në disa shtylla siç janë shërbimet klinike dhe të kujdesit shëndetësor me standardet e Spitalit të Vatikanit apo ato të kërkimit shkencor, inovacionit dhe të themelimit të një sistemi vlerësimi akademik. Kjo lejon krijimin e programeve të studimit në bashkëpunim me Universitetin Katolik ZKM për përgatitjen e stafit mjekësor dhe infermieristik të aftë për të përmbushur nevojat e pacientëve pediatrikë. Z. Massimiliano Raponi tregon për buletin tonë se nisma e re e kujdesit shëndetësor në Shqipëri që synon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të fëmijëve, bashkon dy organizata të frymëzuara nga një ideal i përbashkët dhe standarde të ngjashme.

Do të ketë një ndikim të jashtëzakonshëm shoqëror, thotë ai, dhe do të përfaqësojë një urë të rëndësishme për shkëmbime shkencore dhe njerëzore. Gjatë diskutimit u trajtuan edhe tema e edukimit shëndetësor si pjesë e procesit të parandalimit të sëmundjeve, një shprehje e një kulture dhe stili jetese të përqendruar në mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

Gjatë vizitës në prill të këtij viti delegacioni i drejtuar nga Presidenti i Spitalit Bambino Gesù Prof. Tiziano Onesti vizitoi Spitalin Katolik duke njohur standardet e larta strukturore dhe teknologjike që e vendosin këtë institucion shëndetësor në nivelet më të larta të shërbimit në Shqipëri. Universiteti dhe Spitali Katolik ZKM kanë qenë prej kohësh një pikë referimi për bashkëpunim midis profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe akademikëve në aktivitete të shumta universitare italiane dhe shqiptare.



TË VEGJLIT JANË ÇËSHTJE JETE DHE DEMOKRACIE

Mario De Curtis pediatër dhe lektor në Romë ngriti një pyetje shumë aktuale në gazetën italiane "Avvenire". **Ai u citua ndërsa sillte në vëmendje shqetësimin nëse shëndeti i fëmijëve është ende përparësi në një shoqëri që po plakët.**

Po sjellim në këtë shkrim disa fragmente nga artikulli i tij, të cilat me siguri janë me interes edhe për realitetin shqiptar. «Fëmijëria përmendet shpesh, por rrallëherë konsiderohet për atë që është: kategoria më e brishtë dhe strategjike e shoqërisë. Shëndeti i fëmijëve është një tregues i stabilitetit demokratik, ekonomik dhe kulturor të një vendi. Një fëmijë i shëndetshëm sot do të jetë nesër një i rritur që angazhohet dhe integrohet në shoqëri. Për këtë nevojitet një sistem i qëndrueshëm, i koordinuar dhe i një mbrojtjeje dhe kujdesi të vazhdueshëm, dhe jo vetëm për ndërhyrje urgjente.





Politikat publike nuk i vendosin fëmijët në qendër. Numri i lindjeve po bie ndjeshëm, shërbimet mungojnë, burimet janë të pamjaftueshme dhe kujdesi pediatrik është në vështirësi.

Në shkolla mungojnë hapësira të sigurta, mensa cilësore dhe edukim shëndetësor. Flitet për parandalim, por parandalimi i vërtetë, i cili fillon që në fëmijërinë e hershme, në lagje dhe në familje, mbetet i marginalizuar në axhendën politike.

Të kujdesesh për më të vegjlit nuk është vetëm një zgjedhje etike, por edhe një largpamësi kolektive. Në një vend që po plakët, pushteti politik dhe ekonomik është i përqendruar në duart e të rriturve që shpesh janë të paaftë për të parë përtej të tashmes. Por janë pikërisht vitet e para të jetës ato në të cilat vendoset një pjesë e madhe e fatit individual dhe kolektiv.


Pabarazitë sociale dhe shëndetësore (lidhur me varfërinë, nivelin e ulët të arsimit, vendin e lindjes, statusin e emigracionit apo aftësinë e kufizuar) kanë pasoja që zgjasin për dekada. Shëndet nuk do të thotë

vetëm mungesë e sëmundjes, por edhe mirëqenie, zhvillim harmonik dhe mundësi për t'u rritur në një mjedis të sigurtë, emocionalisht të qëndrueshëm dhe kulturalisht promovues. Shumë shpesh sëmundjet kronike tek të rriturit i kanë rrënjët që në fëmijërinë e hershme. Ndërhyrja e hershme që para ngjizjes, gjatë shtatzënisë dhe në vitet e para të jetës është strategjia më efektive dhe më pak e kushtueshme për të ulur barrën e sëmundjeve në të ardhmen. Një vend me vizion për të ardhmen e vlerëson çdo vendim publik edhe për ndikimin që ka te më të vegjlit. Të garantosh të drejta dhe mbrojtje të barabartë për të gjithë, pavarësisht origjinës, të ardhurave apo gjendjes familjare do të thotë gjithashtu të sigurosh kujdes për të miturit me sëmundje të rralla ose të pashërueshme, të ulësh kohën e birësimeve dhe të forcosh kujdesin paliativ pediatrik që ende mungon në masë të madhe.

Shëndeti i fëmijëve është një zgjedhje politike dhe një investim për të ardhmen. Shumë patologji të të rriturve nisin në fëmijëri dhe adoleshencë dhe t'i injorosh ato do të thotë të heqësh dorë nga një e ardhme më e shëndetshme dhe më e drejtë.

Një shoqëri që harron fëmijët, heq dorë nga vetvetja. Nesër është tepër vonë: sot është koha për të vepruar.

Shëndeti dhe fëmijët



HISTORIA E GRUAS QË DHA DEVOCION E DASHURI

Nënë Tereza



Këtë vit shënohet 115 vjetori i lindjes së Nënë Terezës, shenjtore shqiptare. Nënë Tereza jetoi në Kalkuta (Indi) para Luftës së Dytë Botërore, duke shërbyer si mësuese fillimisht e më pas drejtuese e një shkolle vajzash. Urdhri fetar që ajo krijoi në vitin 1951 mori emrin "Misionarët e Bamirësisë" për t'u shërbyer të varfërve në Indi dhe në botë. Në vitin 1979 shenjtorja shqiptare mori Çmimin Nobel për Paqen dhe për herë të parë bota mësoi asokohe se Nënë Tereza ishte shqiptare.

Në shtator të vitit 2016 Papa Françesku e shpalli Nënë Terezën Shenjtore duke njohur kontributin e saj në shërbim të njerëzimit dhe në shpalljen e mesazhit të krishterë. Me devocionin e saj Nënë Tereza kontribuoi duke mbështetur ndërtimin e Spitalit Katolik të Shqipërisë që sot është kthyer në një nga qendrat më moderne në shërbim të shëndetit të mirë.



FONDACIONI NDËRMJET ENTUZIAZMIT DHE BESIMIT

Ndërtues të
së mirës së
përbashkët



Fr. Ruggero Valentini

President i Fondacionit
Zoja e Këshillit të Mirë, Tiranë

Të dashur bashkëpunëtorë të Fondacionit,

Me rastin e rifillimit të plotë të aktivitetit tonë, dëshiroj t'ju drejtohem me disa fjalë përshëndetjeje dhe urimesh. Muaji shtator sjell dy data domethënëse për historinë tonë dhe për motivimin ideal që na udhëheq në rrugën tonë: **5 shtatori**, festa e Shën Terezës së Kalkutës dhe **22 shtatori**, përkujtimi i të Lumit Luigji Monti. Për ne, kjo përbën një shtysë të re entuziazmi dhe besimi për të nisur një tjetër vit pune, pranë të rinjve dhe të sëmurëve.

Entuziazmi: ashtu siç na e zbulon vetë fjala me prejardhje greke do të thotë një qëndrim shpirtëror i atyre që jetojnë me Zotin.

Besimi: edhe në gjuhën shqipe kjo fjalë i referohet një qëndrimi të përgjegjshëm dhe koherent ndaj tjetrit duke krijuar kështu marrëdhënie pozitive.

Ju e dini sa të përkushtuar jemi për të përmirësuar dhe zhvilluar si në sektorin universitar ashtu edhe në atë shëndetësor **të gjitha shërbimet ndaj njeriut**, të cilat i kemi nisur gjatë këtyre viteve. Fatkeqësisht, pengesat burokratike që nuk varen nga ne ngadalësojnë kohën e realizimit duke zbehur kështu përpjekjet e një organizate jofitimprurëse si e jona.

Shfrytëzoj rastin t'ju ftoj të lexoni dhe të shpërndani botimin tonë online **ZKM Albania**, i cili del çdo muaj për të informuar dhe për të ndërtuar marrëdhënie. Të zënë me punën tonë të përditshme shpesh harrojmë të komunikojmë vlerat tona si brenda ashtu edhe jashtë detyrave tona.

Ju uroj punë të mbarë dhe ju falenderoj për përkushtimin tuaj ndaj të mirës së përbashkët!



200 VITE QË VLEJNË

Aktivite të shumta përkujtimore po mbahen për dyqind vjetorin e lindjes së të Lumit Luigji Monti. Edhe në Shqipëri Fondacioni ZKM ka organizuar disa nisma përmes të cilave studentë, bashkëpunëtorë dhe miq kanë pasur mundësinë të njohin më mirë figurën e Themeluesit. Ndër aktivitetet e realizuara spikasin takimi i zhvilluar në Parkun Qendror të Tiranës ku **Stefania Bruno** rrëfeu në mënyrë artistike dhe të mrekullueshme historinë e Montit përmes artit me rërë. Apo prezantimi i librit të **Ruggero Valentinit** "Fratello è bello" duke iu drejtuar posaçërisht studentëve, si dhe prezantimi i bocetit të një skulpture prej bronzi që paraqet Atë Montin, e cila do të inaugurohet në muajt në vijim. **Rrëfimi i kësaj historie dyqindvjeçare e bën edhe Shqipërinë pjesë të një rrugëtimi tërheqës. Populli shqiptar e ka të rrënjësuar thellë aktin e ndihmës dhe të kujdesit për të rinjtë dhe të sëmurët.**

Frytet shpirtërore, të cilat do të shfaqen përmes një ndjeshmërie në rritje ndaj njerëzve në vështirësi janë pjesë e frymëzimit nga historia e Luigji Montit. Përmes hapjes ndaj dimensioneve të jetës dhe përmes gatishmërisë së të rinjve për ta përqafuar si ide, karizma e Atë Montit do të përcillet brez pas brezi.

ANGIOGRAFI: NIS PUNA!

Teknologji në shërbim të njeriut

Spitali Universitar Zoja e Këshillit të Mirë në Tiranë është pajisur me teknologji moderne dhe një aparaturë të re që do të inaugurohet në javët në vazhdim. Siç shpjegon Fabian Cenko Drejtori Mjekësor i Spitalit ZKM kjo pajisje përfaqëson një potencial të madh në planin e zhvillimit të Departamentit të Kardiologjisë sepse Anxhografi na lejon të zgjerojmë gamën e procedurave të disponueshme për pacientët dhe të sigurojmë trajtime që përputhen me standardet ndërkombëtare duke rritur kompetencat dhe profesionalizmin që tashmë ekziston në ekipin tonë. Karakteristikat e Anxhografit të prodhuar nga kompania Philips i njeh mirë **Ilirian Laçi**, radiolog ndërhyrës dhe përgjegjës i kësaj fushe, i cili shprehet se kjo është një pajisje që përdoret për trajtimin e tumoreve dhe strukturave vaskulare, ndërhyrjen në rastet e hemorroideve dhe këmbës diabetike, kryerjen e ndërhyrjeve të kujdesit paliativ dhe shumë të tjera. Dr. Iliriani ka kryer studime dhe ka fituar përvoja profesionale në disa vende: "Mbah mend që si mjek i ri në spitalin Gemelli të Romës u përballa me një rast të pashpresë, por pikërisht në atë rast pata edhe fatin të zbuloja zgjidhjen, falë potencialit të jashtëzakonshëm të kësaj pajisjeje."

Gjatë viteve Dr. Laçi ka kryer një master në Universitetin Tor Vergata të Romës. Radiologjia ndërhyrëse, siç quhet në gjuhën mjekësore, është një fushë shumë tërheqëse dhe studentët tanë do të kenë mundësi të fitojnë përvojë dhe të ndjekin një specializim. Do të jemi të suksesshëm, thotë doktori për buletin tonë ZKM, nëse arrijmë të krijojmë një specializim në këtë fushë të veçantë dhe të punojmë si ekip.

Falë anxhografit këtu në Spitalin ZKM, tregon ai, do të jemi të parët në Shqipëri që do të kalojmë nga biopsia në trajtim."



Edhe **Aurel Demiraj**, i cili e përdor anxhografin në fushën e kardiologjisë e mbështet këtë ide të punës në grup. Ai shprehet që mjekët do ta vendosin njeriun në vend të parë, përpara fitimeve duke formuar një slogan domethënës që është humanizmi, i cili bën ndryshimin. Dr. Aureli është arsimuar jashtë Shqipërisë dhe aktualisht është pjesë e ekipit mjekësor në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë. Ai thotë se është shumë i motivuar edhe për të punuar në Spitalin ZKM. Dr. Aureli tregon se kardiologjia ndërhyrëse nuk është një risi në Shqipëri, por fryma me të cilën mund të realizohet është e tillë.

Spitali Katolik i Tiranës, shton ai, i plotëson të gjitha kushtet dhe ka një motivim idealist të konsoliduar, të kombinuar me standarde të larta italiane dhe evropiane. Doktori sjell në vëmendje vlerësimin e pacientëve për Spitalin ZKM, të cilët tregojnë për profesionalizmin bazuar në vlerat thellësisht humane.

Duke kujtuar se paisja e re është fjalë e teknologjisë së përparuar mjeku sheh nga studentët dhe specializantët e ZKM në të ardhmen, të cilët do të përfitojnë nga një mjedis profesional, i kualifikuar dhe etikisht frymëzues

Për informacione më të detajuara drejtoheni tek Spitali Katolik ZKM në Rrugën Ana Komnena në Tiranë (Qendra Spitalore Universitare ZKM) - Tel. 00355 445 05 004 info@zoja.al - www.zoja.al

DY LABORATORË TË RINJ KËRKIMORË

Hapësira të reja për
kërkim dhe trajnime
në farmaci

Gjatë vitit akademik 2025–2026 studentëve të Farmacisë në UKZKM do t'u vihen në përdorim edhe dy laboratorë të rinj kërkimorë në fushën e Shkencave Farmaceutike.

Laboratorët do të jenë plotësisht funksionalë që në fillim të vitit të ri akademik dhe do të kenë një sipërfaqe totale prej afërsisht 100 m². Këto salla të reja të mirëpajisura janë projektuar për kërkime të aplikuara dhe eksperimentale; mbështetje mësimore për studentët e programeve të studimeve universitare në Fushën e Shëndetësisë; bashkëpunime me kompani lokale farmaceutike dhe fitoterapeutike; ofrimin e aktiviteteve referuese për institucionet lokale në lidhje me kontrollin e cilësisë dhe zhvillimin e produkteve farmaceutike dhe galenike. Laboratori i Kërkimeve të Kimisë dhe Analizës Farmaceutike dhe Toksikologjisë i dedikohet analizës kimike-farmaceutike të përbërësve Aktivë Farmaceutikë, formulimeve të barnave (galenike dhe jo-galenike); fitoterapeutikëve dhe produkteve bimore. Studentët me ndihmën e

profesorëve Marcello Leopoldo dhe Arvjola Hodaj do të kryejnë aktivitete kërkimore për përgatitjen e tezave eksperimentale, të cilat janë të vlefshme për të diplomuarit në Farmaci dhe programe të tjera studimi në Fushën e Shëndetësisë. Laboratori do të jetë i pajisur me një konfigurim bazë që lejon kryerjen e shumicës së testeve analitike të përshkruara nga farmakologjia italiane dhe ajo evropiane.

Ndërsa laboratori i Kërkimeve Rregullatore të Teknologjisë Farmaceutike dhe Mjekësisë nën kujdesjen e profesorëve Denora Nunzio, Arvjola Hodaj dhe Malvina Hoxha do të ketë si qëllim përgatitjen, paketimin dhe etiketimin e formave farmaceutike me çlirim konvencional në përputhje me rregulloret aktuale italiane dhe evropiane. Në mënyrë të veçantë ky laborator do të studiojë dhe zhvillojë produkte medicinale galenike për përdorim mbi lëkurë, siç janë kremrat, xhelrat, pomadat apo pastat dhe për përdorim oral siç janë tretësirat, emulsionet dhe pezullimet.

10 VJET SUMMER SCHOOL

Qendra Evropiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim (CESPIC) si pjesë integrale e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" organizoi këtë vit në Kampusin ZKM edicionin e 10-të të Shkollës Verore me temë **"Rrënjët e Luftës dhe Vendosja e një Paqeje të Qëndrueshme"**.

Shkolla Verore e këtij viti synon t'i ofrojë një grupi studentësh nga vende të ndryshme të botës informacion dhe analiza shkencore e profesionale mbi rrënjët e luftës, paqes dhe sfidave në ndërtimin e paqes jetëgjatë.

Programi është ndërdisiplinor dhe përfshin tema të tilla si ekonomia, shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe historia, të cilat mentorohen nga lektorë shumë të njohur në botën akademike ndërkombëtare. Këtë vit studentët ndoqën leksione dhe tema të mprehta, aktuale jo vetëm nga Drejtori i CESPIC **Prof. Raul Caruso**, por edhe nga **Prof. Tobias Böhmelt** nga Universiteti i Essex në Britaninë e Madhe apo **Subhasish Chowdhury** nga Universiteti i Sheffield po në Mbretërinë e Bashkuar. **Këtë vit mbushen plot 10 vjet që nga lindja e kësaj shkolle verore, e cila është organizuar për studentë dhe të diplomuar me një interes të fortë në studimin shkencor të Paqes, të cilët do të vazhdojnë studime të avancuara pasuniversitare ose do të bëhen praktikues në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërtimin e paqes.**

Çdo vit shkolla jonë verore mbledh studentë nga vende të ndryshme evropiane dhe jo vetëm, të cilët tërhiqen nga cilësia e jashtëzakonshme e edukimit dhe kulturës së gjerë që ky organizim akademik ofron. Ekipi i profesorëve tanë që përfaqëson një gjeografi të plotë akademike nga Anglia, Greqia, Italia, Turqia, Norvegjia mbulon fusha të ndryshme me ekspertizë bashkëkohore dhe shumë aktuale. Leksionet dhe komunikimi kryhet në gjuhën angleze.



TEKNOLOGJI DHE ARKITEKTURË

UKZKM kontribuon
në mbrojtjen
e trashëgimisë
kulturore

Universitetet janë djepi i burimeve njerëzore të çdo vendi dhe sa më cilësorë të jenë këto institucione akademike aq më e sigurtë është e ardhmja e demokracisë, mirëqenies, zhvillimit ekonomik, shoqëror, kulturor të një vendi dhe popullit të tij. UKZKM ka kontribuar për më shumë se 20 vite në mënyrë sistematike që të adaptojë dhe sjellë në Shqipëri standardet më të mira evropiane duke promovuar mjedisin akademik.

Ide, inovacion, teknologji dhe zhvillim, metoda të përparuara që investojnë zhvillim dhe qëndrueshmëri për të ardhmen; I tillë është projekti që synon instalimin e një sistemi të përhershëm monitorimi strukturor të quajtur SHM Board me teknologji të përparuar të zbulimit, analizës dhe parandalimit të riskut për Sallën e Madhe të Koncerteve të Universitetit të Arteve në Tiranë.

Dikur i njohur si Teatri i Akademisë së Arteve, ai u projektua në vitin 1930 nga arkitekti fiorentin Gherardo Bosio dhe sot përfaqëson një nga shembujt më të rëndësishëm të arkitekturës moderne në Shqipëri. Ruajtja e këtij objekti sipas arkitektëve të UKZKM kërkon një qasje shkencore, teknologjike dhe multidisiplinare.

Për këtë arsye në bashkëpunim me Tecnopolo d'Abruzzo, Universitetin e Firences, Universitetin e Arteve në Tiranë dhe partnerët teknikë Palmerini SCT, West Aquila Srl, Comitech Srl dhe MGAD Design, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka propozuar këtë iniciativë 24-mujore kërkimore dhe zhvillimore e bashkëfinancuar nga AKKSHI (Agjencia Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion në Shqipëri) dhe Tecnopolo d'Abruzzo. Kjo iniciativë, e para e këtij lloji në Shqipëri bashkon ekspertizën akademike, industriale dhe atë projektuese për t'u përballur me një sfidë të rëndësishme: mbrojtjen strukturore të Sallës së Koncerteve të Universitetit të Arteve.

Duke përdorur sensorë të fjalës së fundit të teknologjisë dhe algoritme inteligjente të patentuara për të parandaluar alarmet false, sistemi i instaluar do të jetë në gjendje të zbulojë çdo shenjë të goditejeve strukturore, dridhjeve anormale apo përkeqësimit progresiv të ndërtesës. Kjo do të lejojë jo vetëm ndërhyrjen në kohë, por edhe zhvillimin e një protokollit parashikues mirëmbajtjeje që mund të aplikohet për ndërtesa të tjera historike të Shqipërisë duke e transformuar Teatrin në infrastrukturën e parë të monitoruar dhe të mbrojtur nga ngjarjet natyrore apo vjetërsia.

Në të njëjtën kohë ky projekt do të kthehet në një laborator aktiv kërkimor shkencor. Një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i projektit është perspektiva që krijon për të edukuar, frymëzuar dhe angazhuar. Të dhënat e mbledhura do t'u vihen në dispozicion komunitetit akademik dhe shkencor si dhe institucioneve lokale dhe profesionistëve të fushës. Qëllimi ynë është të nxisim një kulturë të re parandalimi ku teknologjia nuk zëvendëson ndjeshmërinë ndaj trashëgimisë, por përkundrazi e rrit atë me mjete konkrete. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit do të organizohen takime të ndryshme për diskutim: debate publike, seminare dhe konsultime shkencore. Takimi i parë do të mbahet më 15 tetor në Tiranë në Sallën e Madhe të Koncerteve të Universitetit të Arteve që do të pasohet edhe nga një prezantim i ndërmjetëm në Universitetin Katolik ZKM për Bashkinë e Durrësit ku mund të propozohet zbatimi i kësaj teknologjie në ndërtesa të tjera historike në territor. Për këtë prezantim të parë zyrtar dëshirojmë të ndajmë me ju jo vetëm strukturën teknike të projektit, por mbi të gjitha kuptimin e tij më të plotë: rikthimin e vëmendjes tek një e ardhme që mbron një prej simboleve kulturore më ikonike të Tiranës falë bashkëpunimit midis universiteteve, industrisë dhe institucioneve publike. Gjatë takimit të 15 tetorit do të prezantohen objektivat, metodat dhe ndikimi i kësaj iniciative në nivel kulturor, shkencor dhe institucional.

Ne në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" e shohim këtë ngjarje si një mundësi për të ndarë me protagonistët e kohës dhe të rrjeteve ndërkombëtare dobitë e bashkëpunimeve të tilla.

ARKITEKTURA

Tregues i civilizimit të një qyteti

Në nisje të këtij viti akademik duam të ndajmë me lexuesit tanë një eksperiencë të veçantë, atë të emocioneve që solli paraqitja e punëve të studentëve të arkitekturës në UKZKM, në një mjedis të hapur urban. Shumë kalimtarë dhe turistë patën mundësi të ndiqnin me kuriozitet paraqitjen e detyrave të fundvitit nga studentët e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" të programit të studimit në Arkitekturë.

Të pranishmit sfiduan temperaturat e larta të motit dhe ndoqën me kuriozitet paraqitjet e studentëve nën udhëheqjen e profesorit Simone Barbi.

Studentët e vitit të tretë të lëndës "Laboratori i Projektimit" paraqitën projektet në formën e maketeve dhe në formën e vizatimeve teknike duke krijuar një panoramë të këndshme jo vetëm për kalimtarët, por edhe për vetë të rinjtë.



Seanca e paraqitjes së projekteve të fundvitit u zhvillua në hapësirën publike mes Pallatit të Kulturës dhe "Sahatit të Tiranës" bazuar mbi temën "Liqeni, vendi i festës" duke krijuar një atmosferë të ndryshme nga ajo çfarë vetë studentët kryejnë tradicionalisht.

Studentët e kursit IIIB të UKZKM u vlerësuan për nivelin e dijes së fituar përgjatë vitit akademik në fushën e praktikës profesionale.

Erasmus +

GATI PËR NISJE

Drejt vendmbërritjeve të reja evropiane!

Këtë vit të ri akademik Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u ofron studentëve mundësinë për të shijuar një përvojë të shkëmbimeve ndërkombëtare të studimeve përmes programit Erasmus+. Falë marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara nga UKZKM studentët e Mjekësisë, Stomatologjisë, Farmacisë, Arkitekturës dhe Ekonomisë do të kenë mundësinë të njohin thellësisht përvoja ndërkombëtare duke studiuar dhe jetuar në disa nga qytetet më dinamike të Evropës.

Duke nisur nga Roma e cila jeton mes mijëvjeçarëve të historisë e trashëgimisë botërore dhe inovacionit shkencor me Universitetin e Tor Vergatës. Në Parma dhe Firence djepe të artit dhe kulturës evropiane ku tradita akademike harmonizohet me kohët moderne. Në Foxhia dhe Kieti-Peskara në zemër të Italisë mes natyrës që të ofron deti e malësia dhe universiteteve të njohura. Në Valencia të Spanjë një qytet tipik mesdhetar ku shkenca dhe kreativiteti jetojnë nën ndikimin iberik. Në Krakov të Polonisë Kryeqytetit Evropian të Kulturës me një ekonomi në rritje dhe një komunitet studentor shumë aktiv. Çdo universitet i përfshirë në këtë përvojë shkëmbimesh do të jetë një kapitull i ri për t’u shkruar nga studentët dhe jo vetëm, të cilët do të përfshihen aktivisht në studime, shkëmbime kulturore, në miqësi të reja duke krijuar aftësi që do të bëjnë ndryshimin në karrierat e tyre. Ata do të zgjerojnë në mjedise ndërkombëtare akademike edhe perspektivat e tyre profesionale dhe personale. Ndërkombëtarizimi mbetet një përparësi strategjike për UKZKM, i cili çdo vit zgjeron bashkëpunimet e tij dhe promovon iniciativë që synojnë inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të studentëve dhe fakultetit në rrjetin akademik evropian. Ndiqni kanalet tona zyrtare për t’u informuar mbi aplikimet e ardhshme dhe mundësitë e këtyre programeve të ofruara nga universiteti ynë!

PËRVOJA E XHULIOS

UKZKM, studime ndërkombëtare në Farmaci

Njihuni me **Xhulio Martinin** nga Universiteti i Urbinos Carlo Bo, i cili mbylli me sukses para disa javësh semestrin e dytë të vitit akademik 2024/2025 për programin e diplomës në Farmaci. Xhulio kaloi disa muaj në Tiranë në universitetin tonë dhe përvojën e tij e ndau me kënaqësi për buletin e këtij muaji pas përfundimit të studimeve.

“Kur zgjedha të vija në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në një program shkëmbimi, tregon Xhulio, u nxita nga kurioziteti për të njohur një ambient akademik dhe kulturor të ndryshëm nga i imi. Prisja të gjeja një mjedis ndërkombëtar, stimulues dhe me mendje të hapur dhe mund të them se këto pritshmëri u përmbushën plotësisht.

Ardhja ime në Tiranë nisi me një pritje e ngrohtë sepse që nga dita e parë stafi i universitetit më udhëhoqi përmes procesit të orientimit dhe çështjeve praktike duke më bërë të ndihem pjesë integrale e komunitetit universitar. Pavarësisht se isha larg shtëpisë menjëherë u ndjeva si në një familje të re. Nga pikëpamja akademike ndjekja e kurseve ishte e dobishme dhe pasuruese. Nuk vura re shumë



ndryshime nga universiteti në Itali madje mësimet ishin shumë më të përqëndruara ndonjëherë sesa në vendin tim.

Profesorët më krijuan hapësirë për ide dhe pyetje dhe gjithmonë ishin të gatshëm për përgjigje. Stafi administrativ ishte i disponueshëm dhe shumë praktik. Takova njerëz interesantë gjatë studimeve me të cilët



Tirana dhe UKZKM dinë të mirëpresin dhe të pasurojnë ata që janë gati të sfidojnë veten

krijova miqësi të forta që shpresoj se do të vazhdojnë përtej botës akademike. Patjetër që do të kthehem në Tiranë për të ndjekur disa nga diplomimet e tyre në të ardhmen. Jeta e përditshme në kryeqytetin e Shqipërisë ishte një zbulim i vazhdueshëm: një qytet i gjallë, plot kontraste dhe me një frymë të fortë komunitare. Mora pjesë në ngjarje kulturore që më prezantuan me traditat, kuzhinën dhe muzikën lokale. Kjo përvojë la një përshtypje të thellë tek unë njerëzore dhe profesionale. Përmirësova aftësitë e mia gjuhësore, aftësinë time për t'u përshtatur dhe zhvillova veten drejt njohjes së kulturave të ndryshme. Kur e shoh nga një perspektivë akademike kuptoj se fitova aftësi të reja që do të jenë të dobishme për karrierën time të ardhshme. I këshilloj studentët ta provojnë këtë program me kuriozitet dhe pa frikë: hapuni ndaj njerëzve, eksploroni qytetin dhe përfitoni nga çdo mundësi për të mësuar. Mesazhi im për ta është se Tirana dhe UKZKM dinë si t'i mirëpresin dhe të pasurojnë shpirtërisht dhe profesionalisht të gjithë ata që janë të gatshëm të përballen me sfida".

I DREJTI 2026

**Një gjurmët
e kontribuesve për
njerëzit dhe komunitetet**

Në UKZKM do të nisim së shpejti përgatitjet për një proces të ri zgjedhor nga i cili do të dalë emri i të Drejtë për vitin 2026.

Tashmë kemi hedhur hapat e parë me qëllim krijimin e një tradite që synon të përkujtojë ata që kanë kontribuar për njerëzimin apo komunitetet e tyre lokale në ditë të vështira duke sakrifikuar edhe jetën e tyre në shërbim të të mirës së përbashkët.

Zgjedhjet e vitit 2026 do të jenë të tretat rradhazi pas dy proceseve të suksesshme nga të cilat u përzgjedhën emrat e **Carlo Urbanit** mjekut italian dhe Presidentit të ndjerë të Kosovës **Ibrahim Rugova**.

Çdo vit synojmë të pasurojmë procesin që përfshin votimin e fshehtë të studentëve, stafit akademik dhe administrativ dhe miqve apo pacientëve që ditën e votimit gjenden në Kampusin Universitar dhe Spitalor



Zoja e Këshillit të Mirë apo në Klinikën Atë Luigji Monti në Rrugën e Kavajës në Tiranë.

Këtë vit të gjitha fakultetet në UKZKM do të kenë një kohë në dispozicion që të propozojnë para muajit dhjetor emrat e njerëzve që kanë dhënë kontribute për shoqëritë dhe komunitetet dhe më pas nga këta emra të propozuar në mënyrë demokratike do të shkohet drejt votimit të fshehtë në Janar 2026 për të zgjedhur Të Drejtin e ri.

Sipas traditës së krijuar shpallja e emrit fitues do të kryhet në muajin Mars 2026 me gdhendjen e emrit fitues në një nga gurët e Kopshtit të të Drejtëve që ndodhet në Kampusin UKZKM shoqëruar me një ceremoni solemne të rastit.

NGA TIRANA NË ROMË PËRMES SARONO-S

Jehona e
një Jubileu...
pelegrinët
tregojnë përvojat

Këtë verë patëm fatin të jetojmë dy përvoja të jashtëzakonshme besimi dhe bashkësie: **Pelegrinazhin e Bamirësisë me rastin e dyqind vjetorit të Atë Luigji Montit dhe Pelegrinazhin e Shpresës në Romë së bashku me mijëra të rinj nga e gjithë bota. Pelegrinazhi i Bamirësisë ishte një takim me jetën dhe karizmën e Atë Luigji Montit, një njeri që e shndërroi vuajtjen në shërbesë dhe që vazhdon të frymëzojë Kishën përmes Kongregatës që themeloi.**

Nga Cantù në Bovisio Masciago, Milano e Saronno, çdo ndalesë u shënua nga lutjet, vëllazëria dhe të mësuarit. Vizita në shtëpinë e lindjes së Montit dhe lutja në famullitë dhe vendet që ai kaloi na dhanë një ndjesi të gjallë të ecjes përkrah tij.

Mesha e dyqind vjetorit e kremtuar me gëzim, solemnitet ishte një moment kulmor që na bashkoi në falenderim për dëshminë e tij të besimit. E paharrueshme ishte edhe mikpritja e familjeve të Cantù-së, të cilat hapën shtëpitë dhe zemrat e tyre.

Bujaria e tyre e shprehur me thjeshtësi dhe gëzim konkretizonte bamirësinë që Atë Monti mishëronte në figurën e tij. Në veprimet e tyre të përditshme të



mirësisë kuptuam se shpirti i tij nuk jeton vetëm në Kongregatë, por edhe tek laikët që vazhdojnë misionin e tij të dashurisë. Dita e fundit në Saronno me përkujtimin e ndarjes nga jeta të të Lumit Luigji Monti n'a kujtoi se bamirësia nuk është vetëm një veprim, por një thirrje: një thirrje për ta bërë jetën tonë një dhuratë për të tjerët.



PEMËT, MBI TË GJITHA

ZKM i bashkohet projektit "Tre miliardë pemë deri në vitin 2030"



Komisioni Evropian po promovon në mënyrë aktive fushatën për rritjen e gjelbërimit në kontinent duke caktuar një kufi ambicioz kohor, deri në vitin 2030 do të mbillen 3 miliard pemë. Iniciativa fillimisht si vendim politik, tashmë është bërë sa njerëzore aq edhe mjedisore, duke nxitur një ndërgjegjësim për brezat e rinj, për mbrojtjen e natyrës dhe "mushkërive" të planetit.

Edhe Fondacioni "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë mbështet këtë nismë duke shtuar hapësirat e gjelbërta në Kampusin Spitalor dhe Universitar ZKM. Bashkë me arkitektë, peisazhistë, staf mbështetës dhe studentë, Presidenti i Fondacionit fr. Ruggero Valentini inspektoi hapësirat ku do të mbillen pemët e reja. Me këtë nismë, Fondacioni synon të mbjellë sa më shpejt fidane të reja, pa humbur më kohë, pasi pemëve u duhen vite për t'u rritur. Projekti synon të përmbysë një praktikë të përhapur që i konsideron hapësirat e gjelbra si mbushës të hapësirave të pazhvilluara. Hapësirat e gjelbra projektohen përpara ndërtimeve.



Përmes aplikacionit web MapMyTree të gjithë qytetarët mund të marrin pjesë duke mbjellë pemë që të plotësohet objektivi deri në vitin 2030. Çdo person që mbjell një pemë do të ketë mundësi ta regjistrojë dhe ta shohë në hartë pemën e tij si pjesë e kësaj iniciative.

Frans Timmermans, Zëvendës President Ekzekutiv për Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, deklaroi:

"Pemët janë aleatët tanë më të mirë në luftën kundër ngrohjes globale dhe në mbështetjen e biodiversitetit: ato pastrojnë ajrin, freskojnë qytetet dhe thithin CO2. Deri në fund të kësaj dekade duhet të mbjellim tre miliardë pemë të reja në BE. Numëruesi i pemëve do t'i lejojë të gjithë të ndihmojnë në mbjelljen nga një deri në njëqind pemë."



Virginijus Sinkevičius, Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin, deklaroi:

"Premtimi ynë është ambicioz: tre miliardë pemë të reja, të gjitha të mbjella para fundit të kësaj dekade. Por kur shoh entuziazmin e evropianëve për këtë iniciativë, jam i bindur se është e arritshme."

Strategjia e BE-së zbaton këtë projekt në përputhje të plotë me parimet ekologjike që do të thotë se duhet të mbillet pema e duhur në vendin e duhur dhe me qëllimin e përshtatshëm.

Kjo nismë do të shtojë sipërfaqen pyjore të BE-së, do të mbështesë qëndrueshmërinë e saj, do të forcojë biodiversitetin dhe do të ndihmojë në përbalimin e krizës planetare të ndryshimeve që vjen nga ndotja.

Nisma e Fondacionit ZKM përqafton parimin e një ekologjie integrale të mbështetur fuqimisht nga Papa Françesku në letrën e tij "Laudato si".

TAKIMET E ARDHSHME

LUNEDÌ 22 SETTEMBRE
ORE 11:00
CAPPELLA OSPEDALE ZKM



FONDAZIONE
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO
Tirana
Dedicata all'educazione, dedicata alla salute



"QUI È
COMINCIATO
TUTTO"

Santa Messa

FESTA DEL BEATO PADRE LUIGI MONTI

Un'occasione preziosa per ritrovarci come comunità attorno all'altare del Signore, affidando a Lui il cammino che ci attende e lasciandoci ispirare dall'esempio luminoso di Padre Monti, uomo di fede e di carità.





Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

AMBULATORIO DI MEDICINA DEL LAVORO

Uniti per la salute degli Studenti

**L'Ospedale Cattolico
e l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio"
si uniscono per la salute degli studenti di area sanitaria!**

Promuoviamo la salute e la sicurezza attraverso controlli mirati, prevenzione, educazione a uno stile di vita sano e supporto continuo.

“Proteggere gli operatori in corsia e tramite loro anche i pazienti!”



Spitali Katolik
Zoja e Këshillit të Mirë
Përkushtuar Shëndetit Tënd

OTTOBRE ROSA

Mese della Prevenzione del Tumore al Seno

Ogni anno, migliaia di donne affrontano una diagnosi che cambia la vita: **il tumore al seno.**

Ma tutti possiamo fare la nostra parte:

informarci, sensibilizzare e controllarci regolarmente.

Studenti e studentesse, parlate, informatevi, sostenete.

La diagnosi precoce può fare la differenza.

Un controllo, un esame, un gesto d'amore verso sé stesse può salvare una vita.

L'Ospedale Cattolico assicura non solo uno screening ma anche un trattamento del tumore al seno in ogni fase della malattia, grazie a protocolli completi e a un'infrastruttura all'avanguardia.



La prevenzione è la prima cura!



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KESHILLIT TË MIRË



Projekt Kërkimi dhe Zhvillimi AKKSHI 2025
koordinuar nga:
PhD. Ark. ANDIA GUGA
Departamenti i Arkitekturës
Fakulteti i Shkencave të Aplikuara



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



Progetto di Ricerca e Sviluppo AKKSHI 2025
coordinato da:
PhD. Arch. ANDIA GUGA
Dipartimento di Architettura
Facoltà di Scienze Applicate

PREZANTIM PROJEKTI

MONITORIMI STRUKTUROR I SALLËS SË MADHE TË KONCERTEVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE TIRANË

TEKNOLOGJI INOVATIVE PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË
KULTURORE SHQIPTARE

PRESENTAZIONE PROGETTO

MONITORAGGIO STRUTTURALE DELLA GRANDE SALA DEI CONCERTI DELL'UNIVERSITA' DELLE ARTI DI TIRANA

INNOVAZIONE TECNOLOGICA PER LA SALVAGUARDIA DEL
PATRIMONIO CULTURALE ALBANESE



**15/10
2025
ORA 10.00**


Salla e Madhe e
Koncerteve
Universiteti i
Arteve Tiranë
meet.google.com/qui-jaxw-omu

**15/10
2025
ORE 10.00**

Grande Sala dei
Concerti
Università delle Arti
di Tirana
meet.google.com/qui-jaxw-omu



Nuovo libro



**200 Anni di ispirazione:
Padre Luigi Monti**

"MONTAGNE D'ALBANIA"
Piero Ghiglione
*Una guida alpinistica
dell'Albania degli anni '40*



FRATELLO È BELLO
di Ruggero Valentini
*Un minuscolo saggio
narrativo sul protagonismo
giovane nella Chiesa,
a partire dalla vicenda
di Luigi Monti e dei suoi
compagni.*



TUTTI IN ARRESTO.
di Olmo Guagnetti
*La storia ritrovata di Luigi
Monti e dei suoi compagni*



Le copie dei libri si trovano in Biblioteca "Fratel Paolo Ruatti" presso all'Università Cattolica NSBC, Tirana